

# DORACAK – Pjesëmarrja e qytetarëve në punën e qeverisë lokale dhe mekanizmat në luftën kundër korrupsionit



**Advocacy Center**  
for **Democratic Culture**



# **DORACAK**

Pjesëmarrja e qytetarëve në punën e qeverisë  
lokale dhe mekanizmat në luftën kundër  
korrupsionit

**Author: Saša Ilić**

**2022**



**For the publisher:**

**NGO Center for Peace and Tolerance**

**Address: Miloša Obilića b.b. 10500 Gračanica**

**E-mail: [office@ngocpt.org](mailto:office@ngocpt.org)**

**Website: [www.ngocpt.org](http://www.ngocpt.org)**

## PËRMBAJTJA

Hyrje.....	4
KONCEPTET THEMELORE DHE TË PËRGJITHSHME.....	5
Koncepti i qeverisjes së mirë/të keqe .....	5
Koncepti i transparencës së qeverisjes lokale.....	9
RËNDËSIA E MONITORIMIT TË PUNËS SË ORGANEVE NË QEVERITË LOKALE.....	10
Struktura e vetëqeverisjes lokale dhe organet kompetente të saj.....	12
Kompetencat dhe përgjegjësitë e kryetarit të komunës.....	14
Elementet dhe parandalimi i konfliktit të interesit .....	15
DEMOKRACIA E DREJTPËRDREJTË DHE MEKANIZMAT E PJESËMARRJES SË QYTETARËVE.....	15
Financat komunale .....	16
KORRUPSIONI. RYSHFETI. DHURATA.....	19
INSTITUCIONET KOMPETENTE DHE INSTITUCIONET TJERA TË PËRFSHIRA NË PARANDALIMIN, LUFTËN KUNDËR KORRUPSIONIT DHE SANKSIONIMIN.....	20
Përfundimet .....	21

## HYRJE

Ky doracak është përpiluar me synim të mirë, ngase monitorimi i punës së autoriteteve komunale u shërben si qytetarëve ashtu edhe zyrtarëve komunalë në ndërtimin e besimit, avancimin e komunikimit, rritjen e pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë të qytetarëve në krijimin e politikave lokale, gjetjen e zgjidhjeve novatore për problemet dhe krijimin e përbashkët të një mjedisi kundër korrupsionit në komunitet dhe shoqëri në përgjithësi.

Doracaku është përpiluar në stilin e një udhëzuesi rreth strukturës dhe funksioneve të autoriteteve komunale, sipas metodës së ndarjes së departamenteve dhe zyrave zyrtare, me qëllim që çdo individ apo organizatë e interesuar në mënyrën më të thjeshtëzuar të ketë një pasqyrë të funksionimit të komunës, organogramit të saj, si dhe një pasqyrë të të drejtave dhe përgjegjësi të zyrtarëve dhe qytetarëve.

## KONCEPTET THEMELORE DHE TË PËRGJITHSHME

**Nocioni "Komunë"** sipas nenit 4 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale të R. së Kosovës përkufizohet si: *"është njësi themelore e vetëqeverisjes lokale në Republikën e Kosovës, e përbërë nga një komunitet i qytetarëve në një territor të caktuar, të përcaktuar me ligj, e cila ushtron tërë pushtetin i cili nuk është i rezervuar shprehimisht për institucionet qendrore"*.

## KONCEPTI I QEVERISJES SË MIRË/TË KEQE

Ky është një konstatim që shpesh e dëgjojmë/lexojmë në media, forume dhe publikime dhe mund të që: disa punë menaxhohen mirë, dikush menaxhon mirë me departamentet që i janë besuar, dhe mund t'i referohet edhe menaxhimit funksional dhe operativ e në këtë rast menaxhimit të mirë të komunës nga organet e saj në përputhje me ligjin. Megjithatë, për të arsyetuar këtë nocion në përdorimin e tij për vetëqeverisjen lokale, ai duhet t'i përmbahet parimit themelor që është përgjegjësi e organeve dhe zyrtarëve komunal ndaj qytetarëve, komunitetit dhe shoqërisë. Kjo do të thotë se komuna për të vepruar në përputhje me ligjin dhe kushtetutën ka futur në praktikë: transparencën, menaxhimin e përgjegjshëm të resurseve publike, mekanizmat e kontrollit të menaxhimit financiar, përfshirjen e qytetarëve, respektimin e lirisë dhe të drejtave të qytetarëve.

Prandaj, do të paraqesim kuptimin e konceptit të menaxhimit të mirë dhe të keq

### Qeverisje e mirë:

- ✓ Organet komunale (administrata) veprojnë në përputhje me kushtetutën, ligjin, statutin.
- ✓ Puna është transparente, efikase, profesionale dhe në dispozicion të qytetarëve.
- ✓ Puna është në përputhje me nevojat e qytetarëve dhe pritshmëritë e tyre dhe përfshinë qytetarët.
- ✓ Zyrtarët janë në dispozicion të qytetarëve dhe trajtohen në mënyrë të barabartë.

### Qeverisja e keqe:

- ✓ Shkel ligjin dhe vepron në mënyrë të paligjshme, nuk zbaton vendimet e marra.
- ✓ Jo transparente për publikun, merr vendime dhe veprime joprofesionale.
- ✓ Qytetarët nuk janë të përfshirë, keqpërdorë besimin e qytetarëve të dhënë në zgjedhje, keqpërdorë të drejtat dhe kompetencat.
- ✓ Diskriminon në bazë të gjinisë, etnisë, racës dhe fesë.

### ***Nocioni "Korrupsion" për qëllimet e Ligjit Nr. 2004/34 Kundër Korrupsionit ka***

***këtë kuptim:*** "Korrupsion - nënkupton çdo shkelje të detyrës së personave zyrtarë ose përgjegjës në subjektet juridike dhe çdo veprimtari e iniciatorëve apo përfituesve të kësaj sjelljeje, e drejtuar si përgjigje ndaj një shpërblimi që drejtpërdrejt ose indirekt është premtuar, ofruar, dhënë, kërkuar, pranuar apo është pritur për t'u marrë për veten apo për një person tjetër".

### ***Sipas Ligji Nr. 2004/34 shpjegohet nocioni qasje në dokumente publike i cili:***

"garanton të drejtën e secilit person, pa diskriminim mbi çfarëdo baze, për të pasur qasje në dokumente publike, të prodhuara, pranuar, mbajtura apo kontrolluara nga institucionet publike, si dhe të drejtën për ripërdorimin e dokumenteve të sektorit publik".

Ligji këtu është i qartë dhe i saktë dhe nënkupton se e drejta për qasje të lirë në informacione me rëndësi publike është në thelb e drejta e qasjes në dokumente zyrtare. Neni 4 i këtij Ligji shpjegon elementet bazë dhe rëndësinë.

### ***Çfarë është një dokument publik?***

Sipas Ligjit të mësipërm dhe nenit 3. paragrafi 1.2. *Dokument Publik*– nënkupton çdo akt, fakt apo informatë në formë elektronike apo me zë, formë të shtypur, në incizime vizuale apo audiovizuale të prodhuara apo mbajtura nga institucioni publik;

***Në nenin 3.1.3. u shpjegua gjithashtu se informacioni "nënkupton, por nuk kufizohet në, të dhëna, fotografi, vizatime, video, film, raport, akt, tabelë, projekte, drafte ose shtesa të tjera, të cilat prodhohen, pranohen, mbahen ose kontrollohen nga institucionet publike, pavarësisht nëse janë të përfshira në ndonjë dokument, si dhe pavarësisht burimit, kohës së krijimit, vendit të***

*depozitimit ose ruajtjes, mediumin ose formën në të cilën gjendet, emrit ose institucionit publik në emër të cilit është krijuar ose çfarëdo karakteristike tjetër";*

1. E drejta për qasje në dokumente publike e secilit person, si dhe garantimi dhe përmbushja e kësaj të drejte nga ana e institucioneve publike përbën një prej themeleve të institucioneve demokratike dhe transparente.
2. Qasja në dokumente publike bëhet përmes publikimit proaktiv nga ana e institucioneve publike të dokumenteve publike dhe përmes kërkesës së personit për qasje në dokumente publike.
3. Secili person ka të drejtë të ripërdorë dokumentet publike sipas kushteve dhe kufizimeve të përcaktuara me këtë lig.
4. Hapja e të dhënave dhe transparencja në sektorin publik shërben për llogaridhënie ndaj publikut, për zhvillimin dhe avancimin shoqëror, ekonomik dhe demokratik.
5. E drejta për qasje në dokumente publike i takon secilit person në mënyrë të njëjtë dhe të barabartë. Institucionet publike nuk favorizojnë askënd në ushtrimin e të drejtës për qasje në dokumente në krahasim me të tjerët.
6. Kufizimi i të drejtës për qasje në dokumente publike bëhet vetëm në rastet e kufizuara dhe specifike të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.

### ***Si iniciohet procedura apo parashtrohet kërkesa?***

Autoriteti mund të parasheh një formular të kërkesës, por gjithashtu duhet të marrë parasysh një kërkesë që nuk është përpiluar me atë formular. Kur kërkesa bëhet verbalisht, zyrtari përgjegjës për qasje në dokumente publike obligohet të shënoj atë në procesverbalin e mbajtur nga ai. Kërkesa mund të dorëzohet edhe në mënyrë elektronike.

*Kërkuesi në kërkesë shënon elementet bazë:*

- emrin e organit,
- emrin, mbiemrin dhe adresën e tij, përkatësisht selinë nëse kërkuesi është person juridik,
- një përshkrim të informacionit të kërkuar dhe
- të dhëna të tjera që e bëjnë më të lehtë gjetjen e informacionit.

Është e rëndësishme të dini se në kërkesë duhet të theksohet mënyra e shikimit të informacionit ose dokumentacionit të kërkuar, pra nëse duam vetëm një përgjigje nëse autoriteti posedon informacionin e kërkuar dhe/ose duam qasje në dokumentin që përmban informacion në ambientet zyrtare të atij autoriteti



dhe/ose nëse duam që një kopje e atij dokumenti të dorëzohet me postë, në mënyrë elektronike ose vetëm për shikim.

***Informacioni mund të kërkohet nga:***

Të gjitha organet shtetërore (p.sh. Parlamenti, Qeveria, ministritë, gjykatat, prokuroritë, etj.); organet e vetëqeverisjes lokale (p.sh. kryetarët e komunave, organet e administratës komunale, etj.); organizatat të cilave u është besuar ushtrimi i autoritetit publik (p.sh. agjencitë e privatizimit, institucionet, ndërmarrjet publike); subjektet juridike të krijuara ose të financuara në tërësi, pra kryesisht disa nga organet e sipërpërmendura (p.sh. institucionet kulturore, institucionet shëndetësore, fondet shtetërore etj.)

***E drejta për ankesë***

Në rast se institucioni publik ka refuzuar në tërësi apo pjesërisht kërkesën për qasje në dokumente publike apo në rast të heshtjes apo mos përgjigjes së institucionit publik, kërkuesi mund t'i drejtohet me ankesë Agjencisë brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve prej pranimit të vendimit për refuzim ose vendimit për aprovim të pjesshëm të kërkesës për qasje.

***Përveç agjencisë, qytetarët mund të ankohen edhe në Zyrën e Avokatit të Popullit.***

Institucioni i Avokatit të Popullit është organ i pavarur, i cili ndihmon qytetarët në realizimin e të drejtës për qasje në dokumentet publike sipas Kushtetutës, këtij ligji, dhe ligjeve përkatëse që rregullojnë fushëveprimin dhe përgjegjësitë e Avokatit të Popullit. Secili person ka të drejtë t'i drejtohet Institucionit të Avokatit të Popullit me kërkesë apo ankesë nëse konsideron që ndonjë e drejtë e njohur me këtë Ligj apo akte të tjera për qasje në dokumente publike është cenuar.

## KONCEPTI I TRANSPARENCËS SË QEVERISJES LOKALE

### ***Çfarë do të thotë transparencë?***

Puna e qeverisë lokale duhet të jetë publike ose në dispozicion për publikun. Kur puna e organeve të administratës publike është në dispozicion të publikut, qytetarët kanë qasje në mjetet për të monitoruar procesin e vendimmarrjes. Qeveritë lokale gjithashtu mund të jenë proaktive në transparencë, që do të thotë të publikojnë vet informacione me rëndësi publike. Kur qeveritë lokale nuk publikojnë ose publikojnë pjesërisht dhe në mënyrë selektive informacione me rëndësi publike, ekziston transparenca reaktive. Ku në këtë rast, qytetarët mund të ushtrojnë të drejtën e tyre ligjore dhe të kërkojnë informacion në mënyrën e shpjeguar më parë, përmes një kërkesë.

## RËNDËSIA E MONITORIMIT TË PUNËS SË ORGANEVE NË QEVERITË LOKALE

*Për të monitoruar në mënyrë efikase dhe profesionale punën e qeverisë lokale, njohja e ligjeve në vijim është e nevojshme:*

*Ligji për vetëqeverisjen lokale*

*Ligji për zgjedhjet lokale*

*Ligji për qasje në dokumente publike*

*Ligji për parandalimin e konfliktit të  
interesit në ushtrimin e funksionit publik*

Në zgjedhje qytetarët tregojnë besimin për përfaqësuesit të tyre, por kjo nuk nënkupton vetëm një akt sipërfaqësor të detyrës qytetare, por ka një kuptim më të thellë në përgjegjësinë e përfaqësuesve të zgjedhur për të justifikuar jo vetëm transferimin e thjeshtë të pushtetit, por edhe në emër të tyre të kryejnë funksionin e autoritetit në menaxhimin e punëve publike të parapara me ligj. Kjo nënkupton se qytetarët janë punëdhënës dhe si të tillë kanë të drejtë të përdorin mekanizma të ndryshëm verifikimi. Përdorimi i mekanizmave të kontrollit dhe monitorimit është baza e ligjit demokratik për përcaktimin e përgjegjësisë së zyrtarëve të qeverisë dhe jo vetëm në aspektin e ligjshmërisë së tyre në punë, por edhe në përmbushjen e premtimeve parazgjedhore. Me pjesëmarrjen e tyre aktive, qytetarët jo vetëm që shërbejnë si kritikë, por edhe kontribuojnë në korigjimin e parregullsive ekzistuese, nëse ka, e me këtë edhe në rritjen e efikasitetit në punën e vetëqeverisjes lokale. Gjithashtu, qytetarët, shoqatat, kompanitë dhe subjektet e tjera mund të jenë propozues të zgjidhjeve inovative për komunën e tyre me propozimet dhe aktivizmin e tyre, dhe në këtë mënyrë të jenë bashkëpunëtorë progresiv të autoriteteve në fusha të ndryshme, si: në krijimin dhe alokimin e buxhetit, mbrojtjen e mjedisit, mbrojtjen dhe sigurinë, në rastet e fatkeqësive natyrore, bashkëfinancimin (donacionet) e kompanive private etj.

***Modeli zgjedhor në pushtetin lokal, përmbledhje***

- ✓ Zgjedhjet në Kosovë për pushtetin lokal dhe kryetarët e komunave organizohen çdo 4 vjet por dhe në raste emergjente.
- ✓ Kryetari zgjidhet në bazë të sistemit mazhoritar dhe në rast se nuk arrin të fitojë mbi 50% të votave, shkohet në raundin e dytë të votimit me kandidatin që është i dyti në radhë sipas rezultateve të arritura.
- ✓ Anëtarët e kuvendit lokal zgjidhen në bazë të sistemit proporcional. Presidenti i Republikës shpall zgjedhjet lokale çdo katër vjet.
- ✓ Secila komunë do të konsiderohet zonë e vetme zgjedhore.
- ✓ Kandidati zgjidhet Kryetar i Komunës nëse ai apo ajo fiton më shumë se 50%, plus një (1) votë të numrit të përgjithshëm të votave të vlefshme të hedhura në atë komunë. Nëse asnjëri nga kandidatët nuk fiton më shumë se 50%, plus një (1) votë të numrit të përgjithshëm të votave, organizohet raundi i dytë i zgjedhjeve në mes të dy kandidatëve të cilët kanë fituar më së shumti vota të vlefshme.
- ✓ Kandidati i cili fiton shumicën e votave në rrethin e dytë zgjidhet Kryetar i Komunës.
- ✓ Numri i anëtarëve të kuvendit përcaktohet në bazë të numrit të banorëve sipas formulës standarde.
- ✓ Pjesëmarrja e gjinisë së nënpërfaqësuar prej të paktën 30% të anëtarëve të kuvendit duhet të sigurohet në kuvend.

Monitorimi i zgjedhjeve është gjithashtu një mekanizëm efektiv në mbrojtjen e demokracisë, si mjet parandalues në luftën kundër korrupsionit, pra një mekanizëm i cili që në fillim mundëson kontrollin e rregullsisë së procesit zgjedhor gjatë zgjedhjes së pushtetit të qeverisë lokale. Prandaj, duhet të veçojmë dhe të dimë se në Kosovë, në përputhje me Ligjin për zgjedhjet, “subjektet e certifikuara politike, shoqëritë civile, organizatat qeveritare dhe ndërqeveritare, si dhe organizatat ndërkombëtare të specializuara për zgjedhjet dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe përfaqësues të shteteve të huaja, kanë të drejtë të kërkojnë akreditimin e vëzhguesve të tyre të zgjedhjeve”.

## STRUKTURA E VETËQEVERISJES LOKALE DHE ORGANET KOMPETENTE TË SAJ

*Si shembull është marrë struktura e Komunës së Leposaviqit.*

KRYETARI	ADMINISTRATA E KOMUNËS	KUVENDI KOMUNAL
Kabineti i Kryetarit	Drejtoria për administratë të përgjithshme	Kryesues i Kuvendit të Komunës
Nënkryetari i Komunës	Drejtoria për buxhet dhe financa	Asamblastët
Nënkryetari i Komunës për Komunitete	Drejtoria për investime dhe zhvillim ekonomik	
Zyra për burime njerëzore	Drejtoria për shëndetësi	
Zyra e prokurimit publik	Drejtoria për arsim	
Zyra e auditorit të brendshëm	Drejtoria për mbrojtje sociale	
Zyra për çështje juridike	Drejtoria për kulturë, rini dhe sport	
Zyra për komunitete dhe kthim	Drejtoria për shërbime lokale dhe infrastrukture	
Zyra për integritet evropiane	Drejtoria për siguri dhe gjendje të jashtëzakonshme	
	Drejtoria për bujqësi dhe furnizim me ujë	
	Drejtoria për pylltari	
	Drejtoria për urbanizëm dhe planifikim hapësinor, mbrojtjen e mjedisit, pronë dhe banim publik	
	Drejtoria për kadastër dhe gjeodezi	
	Drejtoria për informim dhe teknologjinë informative	

Për një pasqyrë më të qartë si pjesë e monitorimit të punës së vetëqeverisjes lokale, siç thuhet në hyrje të këtij doracaku, do t'i zbërthejmë organet përmes prizmit të ligjit aktual për vetëqeverisjen lokale dhe sipas faktorëve më të rëndësishëm.

### ***Cili është pozicioni ligjor i komunës?***

Komuna është person juridik. Si person juridik, çdo komunë ka kompetenca, në mes tjerash, që:

- a) të padisë dhe të paditet në gjykata;
- b) të posedojë, dhe të menaxhojë pasurinë;
- c) mund të jetë pronare apo bashkëpronare e ndonjë kompanie që është në interes të komunës në raport me qytetarët;
- d) të lidhë kontrata;
- e) të punësojë stafin; dhe
- f) të angazhohet në aktivitete të tjera që janë të domosdoshme për realizimin e përgjegjësive të saj.

### ***Kush e përbën dhe cili është funksioni i Kuvendit Komunal?***

Kuvendi komunal përbëhet nga anëtarët e tij (këshilltarët) të cilët zgjidhen drejtpërdrejt nga qytetarët e asaj komune me mandat katërvjeçar. Përfaqësimi i qytetarëve bazohet në një formulë që u siguron qytetarëve përfaqësim në vendimmarrje. Në krye të kuvendit është kryesuesi i kuvendit. Kuvendi ka vetëm dy komitete të përhershme. Komitetet e tjera krijohen sipas nevojës dhe janë të përkohshme. Komitetet ndihmojnë kuvendin në përmirësimin e punës së tij profesionale dhe në secilën komunë kanë funksione të njëjta.

### ***Cilat janë kompetencat e Komunës?***

Në përputhje me ligjin, komunat realizojnë aktivitetet sipas kompetencave të tyre vetanake (p.sh. zhvillimi lokal ekonomik, planifikimi urban dhe rural, shfrytëzimi i tokës dhe zhvillimi, ofrimi i shërbimeve publike etj.); të deleguara (p.sh. regjistrimi civil, shënimet kadastrale, regjistrimi i biznesit); të zgjeruara (përkujdesi dytësor shëndetësor, sigurimi i institucionit të arsimit të lartë, kulturës etj.). Për komunat me shumicë serbe, kompetencat e zgjeruara janë përshkruar më hollësisht në Ligjin për vetëqeverisje lokale.

## KOMPETENCAT DHE PËRGJEGJËSITË E KRYETARIT TË KOMUNËS

Është e rëndësishme të theksohet se Kryetari i komunës zgjidhet me zgjedhje të drejtpërdrejta në pajtim me Ligjin mbi zgjedhjet lokale dhe zgjidhet për një periudhë katër vjeçare. Funkzioni i kryetarit të komunës mund të përfundoj gjatë mandati të tij në kushtet e përcaktuara me ligj. Për nevojat e temës sonë në këtë doracak do të veçojmë më të rëndësishmet, e ato janë përgjegjësitë dhe kompetencat e tij.

*Përgjegjësitë e kryetarit të komunës sipas Ligjit për vetëqeverisjen lokale janë:*

**a) përfaqëson komunën dhe vepron në emër të saj;**

- b) udhëheq ekzekutivin e komunës dhe administratën e saj dhe mbikëqyr administrimin financiar të komunës;
- c) ushtron të gjitha kompetencat, të cilat nuk i jepen në mënyrë eksplicite kuvendit të komunës apo komiteteve të tij;
- d) ekzekuton aktet e kuvendit të komunës;
- e) emëron apo shkarkon zëvendësit e tij/saj;
- f) emëron dhe shkarkon anëtarët e tij të cilët i ndihmojnë atij në kryerjen e detyrave;
- g) organizon punën dhe drejton politikën e komunës;
- h) propozon rregullore apo akte të tjera për miratim në kuvendin e komunës;
- i) propozon zhvillimin komunal, planet rregullative dhe investuese, propozon buxhetin vjetor për miratim në kuvendin e komunës dhe e ekzekuton buxhetin e miratuar;
- j) raporton para kuvendit të komunës për situatën ekonomiko-financiare të komunës dhe për zbatimin e planeve investuese të komunës, së paku njëherë në gjashtë muaj apo kurdoherë që kërkohet nga kuvendi i komunës; dhe
- k) mund të kërkojë që kuvendi i komunës ta shqyrtojë një akt komunal para hyrjes në fuqi, kur konsideron se akti cenon legjislacionin në zbatim dhe/apo interesin e komuniteteve.
- l) do të konsultojë nënkryetarin për komunitete për çështjet që kanë të bëjnë me komunitetin jo shumicë; dhe
- m) aktivitetet tjera që i caktohen me statut.

## ELEMENTET DHE PARANDALIMI I KONFLIKTIT TË INTERESIT

Si mekanizma për mbrojtjen nga keqpërdorimet e mundshme të pushtetit, ligji ka parashikuar gjithashtu se "pas zgjedhjes së tyre, kryetarët e komunave ndërpresin çdo kontratë apo lidhje që kanë, e cila mund ta vë në pikëpyetje aftësinë e tyre për kryerjen e përgjegjësisive të tyre në mënyrë të drejtë dhe të paanshme. Kryetari i komunës përjashtohet nga procedurat vendimmarrëse dhe administrative që kanë të bëjnë me ndonjë çështje, në të cilën ai, apo ndonjë anëtar i afërm i familjes së tij, ka interes personal apo financiar. Nga kryetari i komunës kërkohet t'i paraqesë konfliktet e interesit sapo të paraqiten ato. Kryetari i komunës mundet vullnetarisht ta përjashtojë veten nga vendimmarrja dhe procedurat administrative, nëse konsideron që mund të ketë konflikt të interesit. Kryetari i komunës shënon çdo ndryshim në gjendjen financiare menjëherë pasi që ai të paraqitet. Statuti dhe rregullorja e punës parasheh masat që duhet të ndërmerren për të përjashtuar kryetarin nga procedurat e vendimmarrjes dhe administrative në rastet kur ka konflikt të interesit."

Të njëjtat rregulla dhe masa të veprimit vlejné edhe për nënkryetarin e komunës.

## DEMOKRACIA E DREJTPËRDREJTË DHE MEKANIZMAT E PJESËMARRJES SË QYTETARËVE

Ndryshe nga demokracia përfaqësuese, ku sundimi politik ushtrohet nëpërmjet përfaqësuesve individualë ose një numri më të vogël përfaqësuesish ose titullarësh, demokracia e drejtpërdrejtë ushtron sundimin politik përmes të gjithë qytetarëve me të drejtë vote. Që do të thotë se demokracia e drejtpërdrejtë nënkupton vendime të drejtpërdrejta të qytetarëve për çështje të caktuara (në këtë rast në kompetencë të komunës) ose plebishit.



<p><b>Informimi publik dhe konsultimi</b></p> <p>Çdo komunë mban periodikisht, së paku dy herë në vit, takime publike në të cilat mund të marrë pjesë secili person apo organizatë me interes në komunë.</p> <p>Në takime të tilla përfaqësuesit komunal informojnë pjesëmarrësit për aktivitetet e komunës, kurse pjesëmarrësit mund të shtrojnë pyetje dhe të japin propozime për përfaqësuesit e zgjedhur komunal.</p>	<p><b>Iniciativa e qytetarëve</b></p> <p>Qytetarët mund të marrin iniciativë për të propozuar rregullore, brenda kompetencave të komunës, për miratim nga kuvendi apo me votën e qytetarëve, në pajtim me ligjin në zbatim.</p>	<p><b>Referendumi</b></p> <p>Qytetarët e Komunës mund të kërkojnë që rregullorja e kuvendit të komunës e miratuar nga kuvendi i komunës, t'i nënshtrohet referendumit.</p>
---	---	--

<p><b>Largimi i kryetarit</b></p> <p>Qytetarët e komunës mund të ndërmarrin iniciativë për largimin e kryetarit të komunës.</p> <p>Kërkesa e tillë duhet të nënshkruhet nga njëzet (20) përqind e votuesve të regjistruar dhe i dorëzohet kryesuesit të kuvendit të komunës, i cili e paraqet çështjen në institucionin përkatës për administrimin e votimit.</p>	<p><b>E drejta e peticionit</b></p> <p>Çdo person apo organizatë me interes në komunë ka të drejtën e prezantimit të peticionit në kuvendin e komunës për çfarëdo çështje lidhur më përgjegjësitë dhe kompetencat e komunës. Kuvendi i komunës shqyrton peticionin në pajtim me statutin dhe rregulloren e punës.</p>	<p><b>Komitetet konsultative</b></p> <p>Kuvendi i komunës themelon komitete këshillëdhënëse sektoriale me qëllim të pjesëmarrjes së qytetarëve në procesin e vendimmarrjes.</p> <p>Anëtarësi e komiteteve përbëhet nga qytetarët dhe përfaqësuesit e organizatave joqeveritare.</p> <p>Komitetet konsultative mund të dorëzojnë propozime, bëjnë hulumtime dhe ofrojnë mendime për iniciativat e kuvendit të komunës, në pajtim me statutin e komunës.</p>
---	---	--

Buxheti komunal përbën një element të rëndësishëm në punën e vetëqeverisjes lokale. Përcaktimi dhe alokimi i buxhetit është një proces kompleks dhe për këtë arsye hierarkia në vendimmarrje si dhe detyrimet e çdo njësie organizative në vetëqeverisjen lokale duhet të respektohen dhe të dihen. Siç e përmendëm, "qeverisja e mirë" është qeverisja që përfshin pjesëmarrjen e qytetarëve dhe është veçanërisht e rëndësishme në këtë segment të buxhetimit me pjesëmarrje. Edhe pse qytetarët nuk janë të përfshirë drejtpërdrejt, ata gjithsesi duhet të përfshihen në mënyra të tjera, si përmes takimeve konsultative, grupeve punuese, sektorit civil apo në ndonjë mënyrë tjetër, por edhe përmes informimit të detyrueshëm në kohë.

### ***Cilat janë bazat ligjore për financimin e pushtetit lokal?***

Sipas Ligjit për financat e pushtetit lokal **Nr. 03/L-049** "Në përputhje me politikat ekonomike kombëtare dhe duke pasur parasysh qëndrueshmërinë fiskale të komunave dhe Qeverisë, Komunitet e Kosovës kanë të drejtë të kenë burime të mjaftueshme financiare me të cilat mund të disponojnë lirshëm gjatë ushtrimit të kompetencave të tyre komunale në përputhje me ligjet e zbatueshme të Kosovës".

### ***Komuna mund të financohet nga:***

të hyrat vetanake të komunës të përcaktuara në nenin 8 të këtij ligji, grantet operative, grantet për kompetencat e shtuara, transferet për kompetencat e deleguara, grantet e jashtëzakonshme, ndihma financiare nga Republika e Serbisë, dhe të hyrat nga huamarrjet e komunës.

### ***Cilat janë kategoritë e burimeve vetanake të të ardhurave?***

taksat komunale, gjobat, tarifat e shfrytëzimit, pagesat e tjera për shërbimet publike të ofruara nga komuna si dhe detyrimet rregullatore dhe gjobat e autorizuar në bazë të këtij ligji;
--

qiratë në pronat e paluajtshme të cilat ndodhen në komunë dhe të cilat janë nën administrimin ose në pronësi të komunës;
--

të hyrat nga shitja e pasurive komunale;
--

të hyrat nga ndërmarrjet të cilat janë plotësisht ose pjesërisht në pronësi të komunës;
---

bashkëpagesa nga konsumatorët e shërbimeve arsimore dhe shëndetësore të cilat ofrohen nga komuna;
---

të hyrat e realizuara nga cilado agjenci, departament ose organizatë e komunës si rezultat i ofrimit të çfarëdo malli ose shërbimi;

interesi në depozitat komunale, nëse ekziston;

grantet dhe/ose donacionet nga qeveritë e huaja (përveç ndihmës financiare nga Republika e Serbisë) ose nga organizatat e jashtme, duke përfshirë organizatat qeveritare dhe joqeveritare si dhe institucionet ndërkombëtare dhe multinacionale.

Të gjitha kategoritë e tjera të të hyrave të cilat janë përcaktuar si të hyra vetanake komunale në bazë të një ligji të Republikës së Kosovës.

### ***Çfarë është korrupsioni, kur, ku dhe si shfaqet?***

Shpjegimi më i thjeshtë - korrupsioni është një marrëdhënie që lind nga përdorimi i pozitës ose ndikimit zyrtar ose shoqëror me qëllim të përfitimeve të paligjshme për veten ose tjetrin.

### ***Kur “Dhurata” kthehet në “Ryshfet”***

Kushdo që në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, kërkon ose pranon ndonjë dhuratë apo përfitim tjetër për vete apo personin tjetër, ose pranon ofertën apo premtimin për dhuratë apo përfitim të tillë, me pretendimin se ai apo ajo është në gjendje të ushtrojë ndikim të padrejtë mbi vendimmarrjen e personit zyrtar, zyrtarit të huaj publik ose personit të huaj zyrtar, pavarësisht nëse ndikimi është ushtuar ose pavarësisht nëse ndikimi i supozuar shpie deri te rezultati i synuar.

### ***Kategorizimi***

- Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar
- Keqpërdorimi dhe mashtrimi në prokurim publik
- Keqpërdorimi i informatës zyrtare
- Konflikti i interesit
- Përvetësimi në detyrë
- Mashtrimi në detyrë
- Përdorimi i paautorizuar i pasurisë
- Marrja e ryshfetit
- Dhënia e ryshfetit
- Ushtrimi i ndikimit
- Mos raportimi ose raportimi i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve financiare

## INSTITUCIONET KOMPETENTE DHE INSTITUCIONET TJERA TË PËRFSHIRA NË PARANDALIMIN, LUFTËN KUNDËR KORRUPSIONIT DHE SANKSIONIMIN

**Këshilli kombëtar kundër korrupsionit** është themeluar në shkurt të vitit 2012 nën patronatin e Presidentit të Kosovës që ka për qëllim bashkëpunimin dhe bashkërendimin ndërmjet institucioneve të Kosovës.

**Task-Forca Anti-Korrupsion pranë Prokurorisë Speciale të Kosovës (PSRK)**, e themeluar në vitin 2012, ndryshe nga prokuroritë themelore të cilat kanë përgjegjësi të merren me rastet e korrupsionit të niveleve më të ulëta, posaçërisht është formuar me detyrën për të luftuar rastet e korrupsionit të profilit të lartë.

**Agjencia Kosovare Kundër Korrupsionit**, funksionale që nga shkurti 2007, është organ i pavarur dhe i specializuar për zbatimin e politikave shtetërore për luftimin dhe parandalimin e korrupsionit.

**Prokuroritë, përfshirë edhe Prokurorinë Speciale të Kosovës**, kanë mandat për të ngritur kallëzime për veprat penale të korrupsionit dhe ato të parashikuara me Ligjin nr. 03/L-052 për Prokurorinë Speciale të Kosovës. Mekanizmi mbikëqyrës i prokurorive është Këshilli Prokurorial i Kosovës.

**Gjykatat Themelore** kanë mandat të vendosin për aktakuzat e ngritura nga prokuroria. Mekanizmi mbikëqyrës i gjykatave është Këshilli Gjyqësor i Kosovës.

**Zyra e Prokurorit Disiplinor (ZPD)**, organ i veçantë dhe i pavarur që i shërben edhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Këshillit Prokurorial të Kosovës.

Qytetarët nuk janë armiq të organeve komunale si dhe nuk janë vetëm shfrytëzues të shërbimeve administrative që ofron komuna, përkundrazi, qytetarët janë pjesë konstruktive e çdo administrate komunale dhe parakusht për qeverisje të mirë. Qytetarët janë partnerë të organeve komunale, të cilët jo vetëm marrin pjesë në zhvillimin e komunës së tyre me një të drejtë apo vullnet politik të caktuar, por me iniciativat e tyre kontribuojnë në respektimin dhe prosperitetin reciprok.

Organet komunale nuk janë domosdoshmërisht të korruptuar, por janë përfaqësues që respektojnë normat ligjore, justifikojnë besimin e qytetarëve të dhënë në fushatat zgjedhore, korrigjojnë menaxhimin e tyre në bazë të kritikave dhe veprojnë në përputhje me parimet morale. I konsiderojnë qytetarët si bashkëpunëtorë dhe punëdhënës të tyre. Janë të vetëdijshëm se pa votën e qytetarëve në shoqëritë demokratike nuk ka organe qeverisëse, prandaj në fund janë përgjegjës para qytetarëve.

**Informacion i rëndësishëm:** Ueb faqja e Agjencisë kundër korrupsionit ku në mënyrë krejtësisht anonime mund të raportoni çdo formë korrupsioni.

<https://akk-ks.org/sr/ballina> Tel 0800 10 800



